



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. A13 prot.

Himarë, më 23.01.2024

PROJEKTVENDIM

Nr. A, datë 23.01.2024

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 03, DATË 29.01.2021, TË KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË, “MBI MIRATIMIN E REGULLORES PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE NDËRVEPRIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE NË BASHKI””

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, lligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe shkresës së Prefektit të Qarkut nr.875/03.10.2023,

V E N D O S A:

1. Në tekstin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki , të miratuar me VKB-në nr.03, datë 29.01.2021, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 45 ndryshohet, si më poshtë vijon:

Neni 45

Administrimi i zgjedhjeve

Procesi i zgjedhjes së kryesive dhe kryetarëve të fshatrave (ligji 139/2015, neni 70/5) dhe i këshillave dhe i ndërlidhësave komunitarë mbikqyret nga këshilli bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT

Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 413/1 prot.

Himarë, më 23.01.2024

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 03, DATË 29.01.2021, TË KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE NDËRVEPRIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE NË BASHKI””.

Të nderuar,

Sikurse jeni në dijeni, në shkresën e Prefektit të Qarkut Vlorë nr.875/01, datë 03.10.2023 , me lëndë: “ Shprehje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Himarë ”, në pikën 3, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Himarë nr.41, datë 22.09.2023 “Për ngritjen e komisioneve për monitorimin e zgjedhjeve të strukturave komunitare në nivel fshati për Bashkinë Himarë” është vlerësuar i ligjshëm me shënimin: “Shfuqiyimi i nenit 45 me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, sipas rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki, për pjesëmarrjen e punonjësit të administratës së bashkisë në komision për monitorimin e zgjedhjeve në nivel fshati, në kundërshtim me nenin 54, pika a e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në të cilin përcaktohet se zgjedhja e këtyre komisioneve është kompetence e Këshillit Bashkiak”. Në zbatim të këtij rekomandimi, po *Ju* paraqesim për miratim projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 03, datë 29.01.2021, të këshillit të Bashkisë Himarë, “Mbi miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki””, ku neni 45 ndryshohet, si më poshtë vijon: “Procesi i zgjedhjes së kryesive dhe kryetarëve të fshatrave (ligji 139/2015, neni 70/5) dhe i këshillave dhe i ndërlidhësave komunitarë mbikqyret nga këshilli bashkiak.”.

SEKRETARI I KËSHILLIT



Elena Memushaj